REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

**DREJTORIA E ARSIMIT**

Nr. 12574 Prot

*Shkodër, më 28.05.2026*

**Lënda:** Dërgim Projekt-Vendim dhe Relacion.

**Dërguar:** Këshillit Bashkiak Shkodër.

**Të nderuar këshilltarë,**

**Bashkëlidhur po ju dërgojmë për shqyrtim Projekt-Vendimin dhe Relacionin:**

"Planin e Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parauniversitar në Bashkinë e Shkodër" sipas dokumentit bashkëlidhur pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Duke ju uruar punë të mbarë,

**Kryetar**

**Benet BECI**

**Me vendim delegimi**

**ZV/KRYETAR**

**Alban PREKA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA SHKODËR**
**DREJTORIA E ARSIMIT**

Nr. 12574/1 Prot

*Shkodër, më 28.05.2026*

**PROJEKT-VENDIM**

**NR. _____ DATË ____ / ____ / 2026**

**PER MIRATIMIN E "PLANIT TË PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË BASHKINË SHKODËR"**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës _____._____.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, neni 8, neni 54 pika k, Ligjin nr. 69/2018 "Për Sistemin e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqiperisë" i ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Shkodër,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë "Planin e Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parauniversitar në Bashkinë e Shkodrës" sipas dokumentit bashkëlidhur pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e bashkisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës, Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Arsimit sipas strukturës organizative dhe përgjegjësisë së tyre.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**
**Benet Beci**

**Me vendim delegimi**
**ZV/KRYETAR**
**Alban PIKKA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

*Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr 1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al*

Zv. Kryetar

______________________

| Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike | Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse | Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar |
|---|---|---|
| ______________________ | ______________________ | ______________________ |

| Drejtoria e Arsimit | Drejtoria Juridike |
|---|---|
| ______________________ | ______________________ |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

**DREJTORIA E ARSIMIT**

Nr. 12574/2 Prot                                                  Shkodër, më 21.05.2025

**Lënda:** RELACION

"PLANI I PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË BASHKINË E SHKODRËS"

**Dërguar:** Këshillit Bashkiak Shkodër.

**Të nderuar këshilltarë,**

Bazuar në nenin 8, nenin 54, gërma "k" të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, si dhe në kuadër të Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, paraqitet për miratim Plani i Arsimit Parauniversitar i Bashkisë Shkodër për periudhën 2026–2028.

Ky plan përbën një dokument strategjik vendor, i cili ka për bazë një analizë të thelluar të kontekstit lokal, strukturave demografike, infrastrukturale dhe sociale, si dhe sfidave që përballon sistemi i arsimit parauniversitar në territorin e Bashkisë Shkodër. Ai synon forcimin e një modeli arsimor gjithëpërfshirës, cilësor, të barabartë dhe të qëndrueshëm, në pajtim me kompetencat ligjore të përcaktuara për bashkitë.

Procesi i hartimit të planit u realizua nga **Grupi i Punës për Hartimin e Planit të Arsimit Parauniversitar**, i cili u ngrit me **Urdhër Nr. 704, datë 17.06.2025** dhe **Urdhër Nr. 1314, datë 22.10.2025** , nga Kryetari i Bashkisë Shkodër. Ky proces zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me strukturat arsimore vendore, aktorët e interesuar dhe komunitetin, duke garantuar transparencë, pjesëmarrje dhe orientim drejt nevojave reale të terrenit.

Hartimi i planit u realizua me mbështetjen nga **Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë** dhe ekspertiza e organizatës **"Smart Processes"**, të cilët kontribuan në analizën e të dhënave, zhvillimin metodologjik dhe formulimin e propozimeve strategjike që përbëjnë trungun e këtij dokumenti.

## 1. Hyrje dhe Konteksti

Planifikimi i arsimit parauniversitar në Bashkinë Shkodër për periudhën 2026–2028 zhvillohet në një kontekst kompleks, i karakterizuar nga ndryshime demografike të thella, tkurrje e popullsisë—sidomos në zonat malore—dhe një dendësi e lartë urbane që kërkon zgjërim dhe modernizim të shërbimeve arsimore. Territori i bashkisë, i përbërë nga 11 njësi administrative dhe një rrjet i gjerë fshatrash, paraqet një mozaik të sfidave territoriale: nga nevojat e menjëhershme për infrastrukturë cilësore në qytet, deri te rreziku i izolimit arsimor në komunitetet rurale.

Në këtë mjedis, sistemi arsimor duhet të përgjigjet jo vetëm ndaj kërkesës së vazhdueshme për edukim në të gjitha grupmoshat, por edhe ndaj detyrës morale për të garantuar akses të barabartë, siguri dhe mundësi reale zhvillimi për çdo fëmijë, pavarësisht nga vendbanimi apo sfondi social.

**2. Vizioni dhe Qëllimet Strategjike**

Bashkia Shkodër ka formuluar një vizion të qartë: **ndërtimi i një sistemi arsimor parauniversitar gjithëpërfshirës, të barabartë dhe të qëndrueshëm**, ku çdo fëmijë ka të drejtë të rritet në një mjedis të sigurt, stimulues dhe në harmoni me nevojat e komunitetit ku banojnë.

Ky vizion konkretizohet në tre qëllime strategjike:

1. **Përmirësimi i infrastrukturës arsimore**, duke synuar plotësimin e standardeve kombëtare dhe krijimin e kushteve bazë për një proces mësimor efektiv;
2. **Zhvillimi gjithëpërfshirës i fëmijëve të moshës parashkollore dhe nxënësve**, me vëmendje të veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuara, ata nga familjet në nevojë dhe grupet sociale të mariginalizuara;
3. **Nxitja e zhvillimit social, kulturor dhe emocional** përmes aktiviteteve jashtëkurrikulare, bashkëpunimit me institucionet kulturore dhe integrimit të shkollës si qendër e jetës komunitare.

**3. Analiza e Situatës Aktuale**

Situata aktuale tregon një sistem arsimor në zhvillim, por me sfida të qarta:

- Në arsimin **parashkollor**, ekziston një rrjet i gjerë kopshtesh, por shumica prej tyre funksionojnë brenda ambientesh shkollore pa hapësira të përshtatura për fëmijët e vegjël. Aksesueshmëria për fëmijët me aftësi të kufizuara është ende e kufizuar, ndërsa frekuentimi mbetet i ulët në krahasim me potencialin demografik.
- Në arsimin **bazë dhe të mesëm**, infrastruktura është e shpërndarë në mënyrë relativisht të barabartë, por kërkon investime të qëndrueshme për mirëmbajtje, modernizim dhe përmirësim të kushteve higjieno-sanitare dhe sigurie.
- Në aspektin e **përfshirjes sociale**, regjistrimi i fëmijëve nga komunitetet romë, egjiptianë dhe me aftësi të kufizuara është shumë i ulët, gjë që tregon nevojën për politika aktive identifikimi, sensibilizimi dhe mbështetjeje prindërore.

**4. Plani i Veprimit dhe Drejtimet e Investimeve**

Për periudhën 2026–2028, Bashkia Shkodër ka përcaktuar një sërë veprimesh konkrete, të orientuara drejt transformimit të sistemit arsimor vendor:

- **Infrastruktura**: Do të realizohen projekte kyçe rikonstruksioni, si ai i kopshtit "Ton Alimhilli", kopshtit "Bep Tusha" dhe shkollës "Ismail Qemali","Xheladin Fishta","Shtoj i Ri"e shumë të tjerë si simbole të angazhimit për mjedise moderne dhe të përshtatura. Po ashtu, do të vazhdojë një program i qëndrueshëm mirëmbajtjeje për të gjitha institucionet arsimore.
- **Zhvilimi i aktiviteteve jashtëshkollore**: Bashkia do të promovojë një kalendar të pasur aktivitetesh kulturore, sportive dhe mjedisore, në partneritet me Qendrën Kulturore "Kujtim Alija", qendrat rinore dhe organizatat lokale, duke e kthyer shkollën dhe kopshtin në hapësira dinamike të jetës komunitare.

Në këtë kuadër, kërkohet miratimi i Planit të Arsimit Parauniversitar të Bashkisë Shkodër 2026–2028 si instrument udhëheqës për zbatimin e politikave arsimore vendorë për këtë afat 3-vjeçar.

**KRYETAR**

**Benet BECI**

**Me Vendim Delegimi**

**ZV/Kryetar**

**Alban PREKA**

**Komisioni**

Rudin Beka

Elvin Brahimi

Brikena Leqejza

Donatela Kalaj

Viktor Sheldija

Agim Bushaj

Lavdije Pateriku

Edvalda Beqiri

Ersada Tukaj

BASHKIA
SHKODËR

# PLANI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR BASHKIA SHKODËR




## 2026 - 2028

**Përmbajtja**


Hyrje dhe konteksti ........ 6

Konteksti administrativ ........ 6

Të dhëna demografike ........ 7

Strukturat etnike ........ 7

Grupmosha 0–4 vjeç: ........ 8

Grupmosha 5–9 vjeç: ........ 8

Grupmosha 10–14 vjeç: ........ 8

Grupmosha 15–19 vjeç: ........ 9

Kuadri ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor ........ 9

Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025 ........ 11

Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor ........ 11

Frekuentimi në kopshte ........ 11

Infrastruktura dhe aksesueshmëria ........ 12

Planifikimi dhe regjistrimi ........ 13

Përfshirja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve ........ 14

Burimet njerëzore dhe zhvillimi profesional ........ 14

Qeverisja dhe strukturat institucionale ........ 14

Analiza e shërbimit në shkollat e arsimit bazë dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2024 – 2025 ........ 15

Frekuentimi në arsimin fillor ........ 16

Frekuentimi arsimi 9-vjeçar ........ 16

Frekuentimi arsimi i mesem ........ 16

Analiza edhe shperndarja e stafit arsimor dhe atij mbështetës në territorin e bashkisë ........ 17

Shërbimi i arsimit sipas njësive administrative ........ 17

Njësia Administrative: Shkodër ........ 17

Njësia Administrative: Ana e Malit ........ 19

Njësia Administrative: Bërdicë ........ 20

Njësia Administrative: Dajç ........ 20

Njësia Administrative: Guri i Zi ........ 20

Njësia Administrative: Postribë ........ 21

Njësia Administrative: Pult ........ 22

Njësia Administrative: Rrethinat ........ 22

Njësia Administrative: Shalë ........ 23

Njësia Administrative: Shosh ........ 23

Njësia Administrative: Velipojë ........ 23

Vizioni, Qëllimet Strategjike, Objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar ........ 24

Përmbledhje e qëllimeve, objektivave dhe aktiviteteve ... 25
Përmbledhje e investimeve (2025–2028) ... 26
Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar ... 28
Të ardhurat vendore dhe transferimet nga qeveria qendrore për shërbimin e arsimit parauniversitar ... 28
Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve) ... 31
Monitorimi dhe vlerësimi ... 45
Indikatorët e Performancës ... 45
Planifikimi i vlerësimit të progresit ... 45
Përfshirja e aktorëve të jashtëm ... 45
Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimi ... 45
Monitorimi i realizimit të aktiviteteve ... 45
Vlerësimi i ndikimit në komunitet ... 46
Rishikimi dhe përshtatja e planit ... 46
Procesi i rishikimit ... 46
Përshtatja e masave dhe aktiviteteve ... 47
Raportimi dhe transparenca ... 47
Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar ... 48
Aneks 2: Të dhëna për shkollat e mesme publike: ... 49
Aneks 3: Të dhëna për arsimin 9-vjeçar (shkollat publike) ... 50
Aneks 4: Të dhëna për kopshtet publike ... 53

## Parathënie

Të investosh në arsim do të thotë të investosh në një të ardhme më të mirë, më të drejtë dhe më të qëndrueshme për fëmijët, familjet dhe vetë komunitetet tona. Ky është një parim i thjeshtë, por thelbësor, që ka udhëhequr vizionin dhe angazhimin e Bashkisë Shkodër në hartimin e këtij Plani të Arsimit Parauniversitar.

Në një territor si i yni – me trashëgimi të pasur kulturore, por edhe me sfida të theksuara demografike, ekonomike dhe territoriale – garantimi i edukimit për çdo fëmijë, pavarësisht nëse jeton në qendër të qytetit apo në një fshat malor, nuk është vetëm një detyrë ligjore: është një përgjegjësi morale dhe politike.

Ky plan 3-vjeçar ndërtohet mbi një vizion të qartë:

Ky vizion është një angazhim real për të ofruar infrastrukturë të denjë, staf të kualifikuar, kushte të sigurta, dhe shërbime mbështetëse për çdo institucion arsimor në territor. Në qendër të këtij plani janë fëmijët – me nevojat, ëndrrat dhe potencialin e tyre – dhe angazhimi ynë për t'i ndihmuar të rriten në një mjedis që i mbështet dhe i fuqizon.

Plani është hartuar përmes një procesi të hapur dhe konsultues me aktorë vendorë, drejtues institucionesh, mësues, edukatorë dhe përfaqësues të komunitetit, për të garantuar që çdo vendimmarrje bazohet në realitete konkrete dhe synon përmirësime të matshme.

***"Bashkia Shkodër synon të zhvillojë një sistem arsimor parauniversitar gjithëpërfshirës, të barabartë dhe të qëndrueshëm, i cili garanton akses për çdo fëmijë dhe të ri në territor, siguron mjedise të sigurta dhe cilësore të të nxënit, në përputhje me nevojat e komuniteteve urbane dhe rurale."***

Si Kryetar i Bashkisë Shkodër, mbetem i vendosur që ta kthejmë këtë vizion në veprim konkret dhe bashkë me të gjithë aktorët e përfshirë, të ndërtojmë një sistem arsimor që e bën krenar qytetin tone, një arsim të barabartë për të gjithë, nga qendra në periferitë, për çdo vajzë dhe çdo djalë që ka të drejtë të ëndërrojë dhe të mësojë.

Benet Beci

Kryetar i Bashkisë Shkodër

# *Falënderime*

*Bashkia Shkodër shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026–2028. Ky proces është realizuar me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë dhe me ekspertizën teknike të "Smart Processes", të cilët lehtësuan analizën, planifikimin dhe ndërtimin metodologjik të këtij dokumenti strategjik vendor.*

*Falënderojmë në mënyrë të veçantë angazhimin e Këshillit Bashkiak të Shkodrës për mbështetjen e dhënë gjatë gjithë procesit, si dhe për përfshirjen aktive në garantimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe transparente.*

*Një vlerësim i veçantë shkon për Zyrën Vendore Arsimore Shkodër (ZVAP), për bashkëpunimin dhe kontributin teknik gjatë mbledhjes së të dhënave, verifikimit të situatës në terren dhe harmonizimit të prioriteteve vendore me politikat arsimore kombëtare.*

*Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive dhe sektorëve vendorë të arsimit, financave, infrastrukturës, shërbimeve sociale, si dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, edukatorëve dhe mësuesve që ofruan informacion të vlefshëm dhe reflektim mbi nevojat reale në terren.*

*Mirënjohje shkon edhe për organizatat e shoqërisë civile, këshillat e prindërve, grupet komunitare dhe partnerët lokalë, të cilët morën pjesë në takime konsultative dhe ndihmuan në pasqyrimin e realitetit arsimor dhe prioriteteve të komunitetit.*

*Ky plan përfaqëson një vullnet të përbashkët për të ndërtuar një sistem arsimor më të mirë, më gjithëpërfshirës dhe më të qëndrueshëm për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Shkodër.*

## Hyrje dhe konteksti

**Konteksti administrativ**
Bashkia Shkodër përfshin një numër njësish administrative, secila prej të cilave luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve publike për komunitetin lokal, përfshirë edhe shërbimet e arsimit parashkollor.
Kjo strukturë e përbërë nga 11 njësi administrative përbëhet nga një ndërthurje e zonave urbane dhe rurale, çka ndikon ndjeshëm në mënyrën e organizimit të shërbimeve publike, si dhe në shpërndarjen e burimeve njerëzore, infrastrukturore dhe financiare.
Prania e diversitetit gjeografik dhe demografik mes njësive administrative kërkon një qasje të diferencuar në planifikimin dhe ofrimin e arsimit parashkollor, për të garantuar akses të barabartë dhe cilësi të njëtrajtshme të shërbimit në të gjithë territorin e Bashkisë.

Aktualisht, Bashkia Shkodër përfshin gjithsej 11 njësi administrative:

- Shkodër
- Ana e Malit
- Bërdicë
- Dajç
- Guri i Zi
- Postribë
- Pult
- Rrethinat
- Shalë
- Shosh
- Velipojë

të cilat përbëjnë bazën e ofrimit të shërbimeve publike, përfshirë arsimin parauniversitar, kopshtet dhe shkollat publike.

| Të dhëna administrative | Vlerë |
|---|---|
| **Sipërfaqja** | 872.71 km² |
| **Popullsi bashkisë** | 154,479 (Cens 2023) |
| **Popullsi Shkodër** | 102,434 (Cens 2023) |
| **Njësi administrative** | 11: Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh, Velipojë |
| **Fshatra të përfshira** | 92 fshatra përmes njësive |

**Të dhëna demografike**

Nga këndvështrimi strukturor demografik në Bashkinë Shkodër ka një popullsi prej 214,897 banore. sipas të dhënave më të fundit. Popullsia e saj karakterizohet nga një shpërndarje territoriale e ndarë ndërmjet zonave urbane dhe rurale, ku rreth 54.6% e banorëve jetojnë në zonat urbane dhe 45.4% në zonat rurale.

Vërehet një qendërzim i lartë urban, në qytetin e Shkodrës si poli kryesor ekonomik, kulturor dhe administrativ. Dendësia mesatare e popullsisë rezulton të jetë rreth 246 banorë për km², ndësa përqendrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodrës.

**Strukturat etnike**

- Bashkia dhe rrethi i Shkodrës janë etnikisht homogjenë: mbi 95 % shqiptarë
- Minoritetet pakicë (Romë, Egjiptianë, Serbë-Malazezë) janë shumë të pakta (< 1 %)

| Bashkia | Njësia Administrative | Popullsia |
|---|---|---|
| **Shkodër** | Shkodër | 117,334 |
| | Ana Malit | 6,187 |
| | Berdicë | 10,342 |
| | Dajç | 9,208 |
| | Guri i Zi | 12,376 |
| | Postribë | 11,968 |
| | Pult | 2,941 |
| | Rrethinat | 29,522 |
| | Shalë | 4851 |
| | Shosh | |
| | Velipojë | 10,168 |
| | **Totali** | **214,897** |

*Burim i informacionit: Gjendja Civile Shkodër.*

Parë nga këndvështrimi i raportit gjinor, popullsia e Bashkisë Shkodër ruan një diferencë të lehtë përsa i përket ndarjes gjinore të popullsisë, në meshkuj e femra duke shprehur një situatë gjinore pothuaj të balancuar.

Gjithmonë duke ju referuar Cens 2023 mund të nxjerrim disa vlera mbi popullsinë sipas grupmoshave si në tabelën më poshtë :

| Grup mosha | Gjithsej *Total* | | | Fushë Arrëz | | | Malësi e Madhe | | | Pukë | | | Shkodër | | | Vau i Dejës | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjithsej | Meshkuj | Femra | Gjithsej | Meshkuj | Femra | Gjithsej | Meshkuj | Femra | Gjithsej | Meshkuj | Femra | Gjithsej | Meshkuj | Femra | Gjithsej | Meshkuj | Femra |
| Gjithsej *Total* | 154 479 | 76 392 | 78 087 | 4 878 | 2 586 | 2 292 | 21684 | 10 879 | 10 805 | 6 222 | 3 159 | 3 063 | 102 434 | 50 225 | 52 209 | 19 261 | 9 543 | 9 718 |
| 0-4 | 7 189 | 3 757 | 3 432 | 158 | 78 | 80 | 870 | 438 | 432 | 233 | 127 | 106 | 5 017 | 2 644 | 2 373 | 911 | 470 | 441 |
| 5-9 | 7 999 | 4 129 | 3 870 | 215 | 127 | 88 | 1 005 | 491 | 514 | 290 | 155 | 135 | 5 466 | 2 839 | 2 627 | 1 023 | 517 | 506 |
| 10-14 | 8 381 | 4 331 | 4 050 | 246 | 121 | 125 | 1 082 | 570 | 512 | 328 | 169 | 159 | 5 642 | 2 909 | 2 733 | 1 083 | 562 | 521 |
| 15-19 | 9 357 | 4 654 | 4 703 | 335 | 174 | 161 | 1 322 | 655 | 667 | 402 | 212 | 190 | 6 120 | 3 051 | 3 069 | 1 178 | 562 | 616 |

*Burim i informacionit: Cens 2023, fq.84.*

**Grupmosha 0–4 vjeç:**
7,189 banorë: Nga të cilët 3757 janë djem dhe 3432 janë vajza.Kjo grupmoshë përfaqëson fëmijët që janë në periudhën e edukimit të hershëm ose në pritje për të hyrë në sistemin parashkollor. Me mbi shtatë mijë fëmijë në këtë grup, kërkesa për shërbime të edukimit parashkollor është reale dhe në rritje në afatin e shkurtër. Kjo shifër nënkupton një nevojë të qëndrueshme për kapacitete në kopshte, përfshirë hapësira, staf edukativ dhe mjete didaktike të mjaftueshme.

**Grupmosha 5–9 vjeç:**
7,999 banorë: Nga të cilët 4129 jenë djem dhe 3870 janë vajza. Kjo është periudha që përfshin kryesisht fëmijët në arsimin fillor. Numri i lartë i fëmijëve në këtë grupmoshë tregon për një vazhdimësi relativisht të qëndrueshme të popullsisë në hyrje të sistemit shkollor. Për autoritetet arsimore, kjo nënkupton nevojën për klasë të mjaftueshme, mësues të specializuar dhe përmirësim të infrastrukturës së shkollave fillore në të gjithë territorin e bashkisë, përfshirë zonat rurale.

**Grupmosha 10–14 vjeç:**
8,381 banorë: Nga të cilët 4331 jenë djem dhe 4050 janë vajza.Kjo grupmoshë përfaqëson nxënësit që ndjekin arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët. Një numër disi më i lartë se ai i grupmoshës 5–9 tregon se për disa vite më parë, shkalla e lindshmërisë ishte më e lartë, ose që kthimet e përkohshme migratore kanë ndikuar në rritjen e numrit të fëmijëve në këtë moshë. Kjo përkon me nevojën për

shkolla 9-vjeçare funksionale dhe staf mësimdhënës të përgatitur për t'u përballur me ngarkesa të mundshme.

**Grupmosha 15–19 vjeç:**
9,357 banorë: Nga të cilët 4654 jenë djem dhe 4703 janë vajza. Ky grup përfshin të rinjtë që janë në fazën e arsimit të mesëm të lartë. Meqenëse është grupmosha më e madhe ndër të katërtat, ajo reflekton një peshë të lartë të kërkesës për gjimnaze, qëndra formimi profesional dhe orientim karriere. Kjo moshë është edhe më e ekspozuar ndaj emigracionit të hershëm, ndaj është thelbësore të ofrohen alternativa reale zhvillimi, duke kombinuar arsimin me mundësitë e punësimit local.

**Kuadri ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor**

Zbatimi i funksioneve të Bashkisë Shkodër në fushën e arsimit parauniversitar mbështetet në një kuadër të gjerë kushtetues, ligjor dhe politik, i cili përcakton të drejtat, detyrimet dhe kompetencat e institucioneve publike për garantimin e të drejtës për arsim.

Bazën më të lartë ligjore e përbën Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ku në nenin 57, pika 1, sanksionohet e drejta për arsim për të gjithë qytetarët. Kjo e drejtë konkretizohet më tej përmes Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar me Ligjin nr. 48/2018, i cili përcakton strukturën dhe funksionimin e arsimit në të gjitha nivelet, duke përfshirë arsimin parashkollor, bazë, të mesëm të përgjithshëm dhe profesional. Ky ligj rregullon gjithashtu standardet e cilësisë, përfshirjes, vlerësimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore.

Është e rëndësishme të vendoset theksi mbi faktin që Strategjitë Kombëtare dhe Ndërsektoriale luajnë një rol kyç në inkuadrimin sa më të saktë të nevojave për përmirësim të sistemit arsimor parauniversitar. Sistemi arsimor në Republikën e Shqipërisë përfshin pesë nivele kryesore :

- Arsimi parashkollor – KNSA 0, mosha 3-6 vjeç;
- Arsimi fillor – KNSA 1, mosha 6-10 vjeç;
- Arsimi i mesëm i ulët – KNSA 2, mosha 11-14 vjeç;
- Arsimi i mesëm i lartë – KNSA 3, mosha 15-18 vjeç;

Arsimi parashkollor ofrohet në kopshte ku funksionojnë tre grupe 3-4, 4-5 dhe 5-6 vjeç. Fëmijëve të moshës pesë vjeç, të cilët nuk kanë ndjekur kopshtin për arsye te ndryshme apo në vendbanimin e të cilëve nuk ka kopsht, u mundësohet ndjekja e klasës përgatitore, me synim integrimin në arsimin e detyruar.

Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" u njeh bashkive kompetenca për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e çerdheve dhe kopshteve publike, si dhe role mbështetëse në arsimin bazë dhe të mesëm, përmes sigurimit të infrastrukturës, përfshirjes sociale dhe koordinimit me institucionet qendrore.

Në nenin 23. Përcakton qartë ; "Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe".

Këto funksione financohen dhe mbështeten në përputhje me Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", dhe Ligjin nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor", të cilët përcaktojnë rregullat e menaxhimit financiar në nivel vendor. Po ashtu, Ligji nr. 9632/2006 "Për

sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, shërben si mjet për mobilizimin e të ardhurave që bashkia mund të përdorë për të mbështetur sektorin e arsimit.

Në nivel zbatimi, funksionimi i institucioneve arsimore rregullohet nga një sërë aktesh nënligjore. Ndër më të rëndësishmet është Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020, që miraton rregulloren e përgjithshme për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, si dhe Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023, që përcakton normat për numrin e nxënësve në klasë dhe ngarkesën mësimore për mësuesit.

Po ashtu, udhëzimi i përbashkët MAS-MEKI nr. 20, datë 13.08.2025, specifikon organizimin e vitit shkollor 2025–2026, ndërsa Udhëzimi nr. 25, datë 25.07.2018, përcakton ngritjen dhe funksionimin e bordeve të institucioneve arsimore, si mekanizma pjesëmarrjeje dhe monitorimi përcaktim i zgjëruar edhe me hyrjen në fuqi te Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Kopshteve dhe Çerdheve" me nr.568 datë 26.07.2024.

Në përputhje me parimet e gjithëpërfshirjes dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, Bashkia Shkodër udhëhiqet gjithashtu nga Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" dhe Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", të cilët kërkojnë ndërhyrje të koordinuara për mbështetjen e fëmijëve në nevojë dhe parandalimin e përjashtimit social. Në këtë drejtim, udhëzime specifike si Udhëzimi nr. 21, datë 08.08.2014, për rritjen e frekuentimit të arsimit nga fëmijët romë, dhe Plani Kombëtar i Veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025, përbëjnë udhërrëfyes për politikat lokale në territorin e Bashkisë Shkodër.

Një fushë me rëndësi të veçantë është edhe ofrimi i shërbimit psiko-social në shkolla, i cili rregullohet me Urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020, si dhe me udhëzuesin për praktikën e punës së shërbimit psiko-social shkollor, të hartuar për stafet e bashkive dhe të zyrave vendore arsimore si dhe Urdhër nr. 483, datë 19.09.2025 i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit "Për disa ndryshime në urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psikosocial", i ndryshuar. Gjithashtu, për të garantuar një ambient të sigurt dixhital për fëmijët, zbatohet Udhëzimi i përbashkët MAS-MShMS nr. 658, datë 23.09.2019, i cili përcakton masa për mbrojtjen e tyre nga përmbajtjet e dëmshme në internet.

Nëpërmjet këtij kuadri të gjerë ligjor dhe politik, Bashkia Shkodër vepron si një aktor kyç në zbatimin e politikave arsimore dhe sociale, duke siguruar një qasje të koordinuar dhe të ndjeshme ndaj nevojave të fëmijëve dhe familjeve në territorin e saj.

## Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025

### Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor

Në Bashkinë Shkodër shpërndarja e institucioneve arsimore sipas njësive administrative tregon një prani të konsiderueshme të infrastrukturës shkollore dhe të arsimit parashkollor në të gjithë territorin. Bazuar në të dhënat e paraqitura, në Bashkinë Shkodër funksionojnë 51 kopshte publike të shpërndara në zonat urbane dhe rurale të territorit të saj. Shpërndarja gjeografike e kopshtit tregon një përpjekje për të garantuar akses të barabartë në edukimin parashkollor, si në qendrat urbane ashtu edhe në zonat më të thella rurale.

| Njesia Administrative | Numri i Kopshteve |
|---|---|
| **Shkodër** | 21 |
| **Rrethinat** | 9 |
| **Bërdicë** | 3 |
| **Guri i Zi** | 5 |
| **Postribë** | 5 |
| **Ana e Malit** | 4 |
| **Dajç** | 1 |
| **Velipojë** | 3 |
| **Pult** | 0 |
| **Shalë** | 0 |
| **Shosh** | 0 |

### Frekuentimi në kopshte

Në Bashkinë Shkodër, të dhënat më të fundit demografike nga INSTAT tregojnë se numri total i fëmijëve në grupmoshën 3–6 vjeç arrin në 3,792, prej të cilëve 2,169 në qytet dhe 1,623 në njësi adminstrative. Nga kjo popullsi, rreth 2000 fëmijë janë të regjistruar në institucionet parashkollore publike, me një shpërndarje gjinore prej 1,069 në qytet dhe 931 ne njësi administrative.

Kjo panoramë nënvizon nevojën për ndërhyrje të mirëorientuara që synojnë jo vetëm zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese, por edhe rritjen e ndërgjegjësimit komunitar për rëndësinë e edukimit të hershëm. Përmirësimi i infrastrukturës, garantimi i aksesit të barabartë dhe zbatimi i masave mbështetëse për familjet në nevojë janë çelës për të siguruar një edukim gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë fëmijët e moshës 3–6 vjeç në territorin e Bashkisë Shkodër.



**Infrastruktura dhe aksesueshmëria**

Bashkia Shkodër po bën hapa të rëndësishëm për ta bërë arsimin parashkollor më të përfshirës, të sigurt dhe të përshtatshëm për nevojat e fëmijëve të gjitha moshave.
Nga 51 kopshte ekzistuese, 17 funksionojnë tashmë në godina të veçuara, ndërsa shumica janë të integruara në ambientet e shkollave; një model që ofron mundësi për bashkëpunim institucional dhe përdorim më efikas të burimeve.
Në këtë proces përmirësues, identifikohen disa sfida që mund të shndërrohen në mundësi konkrete për investime të drejtuara.
Në të njëjtën kohë, Bashkia ka filluar të vë re nevojën për përmirësime në aksesin fizik dhe mjedisin edukativ, veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara.
Si pjesë e një vizioni të qartë për arsim cilësor, Bashkia Shkodër ka identifikuar disa kopshte që do të përfitojnë nga një program i strukturuar rikonstruksioni, me synim që të plotësojnë standardet infrastrukturore. Prioritetet përfshijnë instalimin e rampave, tualeteve të përshtatura për fëmijë dhe krijimin e këndeve lojrash funksionale, elemente kyçe për një zhvillim të barabartë.
Në këtë kontekst, kopshtet si **"Edith Durham"**, **"Ngjyrat"**, **"Xixëllonjat"** dhe **"Njomëzat"** paraqesin modele frytëdhënëse të integrimit të arsimit parashkollor me shërbimet sociale mbështetëse, duke e sjellë arsimin më afër komunitetit dhe duke promovuar një qasje gjithëpërfshirëse.
Struktura e grupeve po përmirësohet gradualisht. Aktualisht, kopshtet më të mëdha si **"Ngjyrat"**, **"Ismet Sali Bruçaj"**, **"Ton Alimhilli"** ofrojnë sistemin më të zhvilluar me katër grupe të ndara (të para, të dyta, të treta), duke reflektuar kapacitetin për diferencim sipas moshës dhe përgatitje të mirëfilltë për shkollën fillore.
Megjithëse shumica e kopshteve operojnë me një grup të përzier, ky fakt tregon një bazë fleksibël që mund të fuqizohet me staf të ri, hapësira shtesë dhe planifikim më të mirë të burimeve.
Me një strategji të koordinuar, Bashkia Shkodër ka potencialin për të transformuar infrastrukturën e kopshteve në një sistem modern, të përshtatshëm për të gjithë fëmijët dhe në pajtim me standardet kombëtare, duke investuar jo vetëm në ndërtesa, por në të ardhmen e çdo fëmije.

Tabela më poshtë paraqet shpërndarjen e grupeve edukative në kopshtet e Bashkisë Shkodër:

| Kopshti | Grupe të para | Grupe të dyta | Grupe të treta | Grupe të përziera | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|
| **1."1 Qershori"** | 1 | | 1 | 1 | 3 |
| **2."Ngjyrat"** | 1 | 1 | 1 | 1 | 4 |
| **3."Ajasëm"** | | | | 1 | 1 |
| **4."Ali Laçej"** | | 1 | 1 | | 2 |
| **5."Azem Hajdari"** | | 1 | 1 | | 2 |
| **6."Bep Tusha"** | 1 | 1 | 1 | | 3 |
| **7."Dëshmorët e Prishtinës** | | | | 1 | 1 |
| **8."Fetah Barbullushi** | 1 | 1 | 1 | | 3 |
| **9."Gjuhët e Huaja"** | | | | 1 | 1 |
| **10."Ismail Qemali"** | | | 1 | | 1 |
| **11."Ismet Sali Bruçaj"** | 1 | 1 | 1 | 1 | 4 |
| **12.Liria"** | | | | 1 | 1 |
| **13."Njomëzat"** | 1 | 1 | 1 | | 3 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **14.“Ndoc Mazi”** | | | 1 | 1 | 2 |
| **15.“Pashko Vasa”** | | | | 1 | 1 |
| **16.“Edith Durham”** | 1 | 1 | 1 | | 3 |
| **17.“Ruzhdi Daca”** | | | | 1 | 1 |
| **18.Shirokë** | | | | 1 | 1 |
| **19.“Ton Alimhilli”** | 2 | 1 | 1 | | 4 |
| **20.“Zija Buliqi”** | | | 1 | 1 | 2 |
| **21.Zogaj** | | | | 1 | 1 |
| **22.Bardhaj** | | 1 | 1 | | 2 |
| **23.Isa Jakupi** | | | 1 | 1 | 2 |
| **24.Haxhi Hajdari** | | | 1 | 1 | 2 |
| **25.Tring Smajli** | | | 1 | 1 | 2 |
| **26.Guci e Re** | | | | 1 | 1 |
| **27.Hot i Ri** | | | | 1 | 1 |
| **28.Shtoj i Ri** | | | | 1 | 1 |
| **29.Shtoj i Vjetër** | | | | 1 | 1 |
| **30.Zues** | | | | 1 | 1 |
| **31.Elbacë** | | | | 1 | 1 |
| **32.Muriqan** | | | 1 | 1 | 2 |
| **33.Oblikë** | | | | 1 | 1 |
| **34.Hasan Dardhanjori** | | 1 | | 1 | 2 |
| **35.“Frederik Gjon Gjoni”** | | | | 1 | 1 |
| **36.“Agim Tafili”** | | | | 1 | 1 |
| **37.Trush** | 1 | 1 | 1 | | 3 |
| **38.“Adem Haxhija”** | | 1 | 1 | | 2 |
| **39.Dragoç** | | | | 1 | 1 |
| **40.Kullaj** | | | | 1 | 1 |
| **41.Drisht** | | | | 1 | 1 |
| **42.Mes-Myselim** | | | | 1 | 1 |
| **43.“At Gjon Karma”** | | | 1 | 1 | 2 |
| **44.Kuç** | | | | 1 | 1 |
| **45. Juban** | | | | 1 | 1 |
| **46.Rrenc** | | | | 1 | 1 |
| **46.Vukatanë** | | | | 1 | 1 |
| **48.Shirq** | | | | 1 | 1 |
| **49.Nikollë Zogorjani”** | | | | 1 | 1 |
| **50.Nj.A.Velipojë** | | | | 1 | 1 |
| **51.“Gjergj Vate Martini”** | | | | 1 | 1 |

**Planifikimi dhe regjistrimi**

Bashkia Shkodër po punon aktivisht për të optimizuar shpërndarjen e fëmijëve në kopshte, duke synuar një përdorim më efikas të kapaciteteve ekzistuese. Në kuadër të këtij procesi, është miratuar **Rregullorja Nr. 568, datë 26.07.2024**, “Për organizimin dhe funksionimin e kopshteve dhe çerdheve të Bashkisë Shkodër”, e cila ka konsoliduar regjistrimin e fëmijëve sipas vendbanimit, një hap i rëndësishëm drejt transparencës dhe planifikimit të mirëfilltë të shërbimeve.
Në këtë kontekst, Bashkia ka nisur një serë ndërhyrjesh infrastrukturore që po përmirësojnë në mënyrë të dukshme kushtet në kopshte. Këto investime jo vetëm që rrisin sigurinë dhe higjienën, por edhe krijojnë mjedise më të përshtatshme për lojë, mësim dhe zhvillim të plotë të fëmijëve.

Përmirësimet e realizuara deri tani si zëvendësimi i dritareve, rinovimi i fasadave, modernizimi i tualeteve dhe shumë ndërhyrje të tjera infrastrukturore, kanë sjellë një cilësi më të lartë shërbimi arsimor.
Këto ndryshime:

- Lehtësojnë qasjen për fëmijët dhe stafin,
- Stimulojnë mësimin përmes lojës në mjedise të sigurta dhe të stimuluese,
- Mbështesin zhvillimin fizik, emocional dhe shoqëror të çdo fëmije.

Megjithëse nevojat mbeten të konsiderueshme, për shkak të mungesës së investimeve të mjaftueshme në vitet e kaluara, angazhimi i tanishëm i Bashkisë Shkodër tregon një vendosmëri të qartë për ta bërë arsimin parashkollor më gjithëpërfshirës, të barabartë dhe të përshtatshëm për të gjithë.
Me një plan të qëndrueshëm dhe përkrahje të vazhdueshme, kopshtet e Shkodrës kanë potencialin për t'u transformuar në modele referimi për arsim cilësor në nivel vendor.

**Përfshirja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve**

Përfshirja e fëmijëve nga grupet e margjinalizuara vazhdon të paraqesë një sfidë thelbësore në territorin e Bashkisë Shkodër. Numri i fëmijëve të regjistruar nga këto grupe është ende i pakët krahasuar me përfaqësimin e tyre demografik.
Në arsimin parashkollor për vitin shkollor 2024-2025 kanë frekuentuar **15 fëmijë romë, 24 egjiptianë** dhe **24 fëmijë me aftësi të kufizuara (AK).**
Në arsimin 9-vjeçar, këto numra rriten në **68 nxënës romë, 75 egjiptianë** dhe **60 fëmijë me AK,** ndërsa në gjimnazet publike regjistrohen **0 nxënës romë, 11 egjiptianë** dhe **5 me AK.**
Përtej kësaj, **8 nxënës me AK** kanë frekuentuar shkolla të bashkuara. Këto shifra tregojnë se, me gjithë përmirësimet e bëra, akoma ekziston një hendek në aksesin dhe përfshirjen e barabartë të këtyre grupeve, veçanërisht në nivelet e mësipërme arsimore.
Bashkia Shkodër ka ndërmarrë një angazhim të qëndrueshëm për të forcuar përfshirjen sociale dhe për të identifikuar nevojat specifike të fëmijëve në situata të cënueshme. Një nga forcat kyçe në këtë drejtim është ngritja dhe funksionimi i **Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve** dhe të **Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF)** në të gjithë territorin bashkiak, si strukturë institucionale që ofron mbështetje të specializuar për fëmijët në rrezik.
Së bashku me këtë, në shumë Njësi Administrative janë aktivizuar **Qendrat Komunitare Multifunksionale "Për Familjen"**, të cilat luajnë një rol vendimtar në ofrimin e shërbimeve të përshtatura për komunitetet romë dhe egjiptianë, duke promovuar ndërgjegjësimin për rëndësinë e arsimit të hershëm dhe duke siguruar lidhje direkte me familjet në nevojë. Këto iniciativa reflektojnë përkushtimin e Bashkisë për një sistem arsimor jo vetëm më të hapur, por edhe më gjithëpërfshirës, ku çdo fëmijë pavarësisht nga sfondi i tij ka të drejtë të rritet, të mësojë dhe të zhvillohet në një mjedis të sigurt, të respektueshëm dhe të barabartë.

**Burimet njerëzore dhe zhvillimi profesional**

Stafi edukativ përbëhet nga 121 mësuese, nga të cilat 14 janë ndihmëse dhe mbështesin 24 fëmijë me aftësi të kufizuara. Kjo nënkupton çdo mësues ndihmës mbështet mesatarisht 1 deri në 2 fëmijë. me AK. Mësueset ndjekin trajnime vjetore të detyrueshme që mundësohen falas nga ZVA. Bashkia po bashkëpunon dhe mbështet trajnimin e stafit me një paketë trajnimesh për emergjencat, ndihmën e parë dhe menaxhimin efektiv të kopshtit në kuadër të Projektit "Bashki të Forta", financuar nga Qeveria Zvicerane. Vlerësimi i brendshëm është një proces që po institucionalizohet dhe do të shërbejë si mjet për përmirësim të vazhdueshëm.

### Qeverisja dhe strukturat institucionale

Shumica e kopshteve në territorin e Bashkisë Shkodër kanë ngritur Këshillin e Prindërve, të cilët luajnë një rol kyç në promovimin e pjesëmarrjes së komunitetit në menaxhimin e shërbimit arsimor. Megjithatë, në disa Njësi Administrative identifikohet një nevojë e qartë për fuqizimin e strukturave

vendimmarrëse sidomos të Bordit të Kopshtit dhe Komisionit për Shëndetin, Sigurinë dhe Mjedisin me qëllim forcimin e kapaciteteve lokale për drejtueshmëri gjithëpërfshirëse.

Në këtë kuadër, ekziston një **Rregullore e qartë** që rregullon mekanizmat e komunikimit institucional ndërmjet Bashkisë dhe këtyre strukturave bashkëmenaxhuese. Zbatimi i plotë dhe funksionalizimi i vazhdueshëm i tyre do të kontribuojë në rritjen e **transparencës, llogaridhënies publike** dhe **angazhimit aktiv të prindërve dhe komunitetit** në proceset e planifikimit, monitorimit dhe përmirësimit të shërbimeve arsimore parashkollore. Kjo qasje pjesëmarrëse është thelbësore për ndërtimin e një sistemi arsimor më të hapur, të besueshëm dhe të përgjegjshëm ndaj nevojave të fëmijëve dhe familjeve.

## Analiza e shërbimit në shkollat e arsimit bazë dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2024 – 2025

VITI SHKOLLOR 2024-2025




Shkollat në territorin e Bashkisë janë të organizuara dhe të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë sa më mirë nevojat arsimore të komunitetit. Ato klasifikohen në disa nivele sipas ciklit të edukimit që ofrojnë, duke përfshirë: shkolla fillore (4 gjithsej), shkolla 9-vjeçare (58 gjithsej) dhe shkolla të mesme (13 gjithsej).

- **Shkollat fillore** u shërbejnë fëmijëve në fazat e para të edukimit, duke u ofruar njohuritë bazë në lexim, shkrim, matematikë dhe lëndë të tjera themelore. Ato janë të përhapura në mënyrë të tillë që të jenë sa më pranë vendbanimeve për të siguruar akses të lehtë për nxënësit e vegjël.
- **Shkollat 9-vjeçare**, gjithsej 58 në numër, përfshijnë si ciklin fillor, ashtu edhe atë të mesëm të ulët, dhe janë projektuar për të ofruar një arsim të plotë bazë. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin akademik dhe shoqëror të nxënësve dhe përgatitjen e tyre për nivelin e ardhshëm arsimor.
- **Shkollat e mesme**, në numër prej 13, që përfshijnë gjimnazet shkollat e mesme të bashkuara, janë institucione që synojnë të formojnë të rinjtë për studime të mëtejshme universitare apo për përgatitje për tregun e punës. Këto shkolla janë të vendosura në zona strategjike për të përfshirë një numër sa më të madh nxënësish nga zona të ndryshme të bashkisë.

Në tërësi, rrjeti arsimor i Bashkisë është konceptuar për të siguruar mundësi të barabarta arsimimi për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, pavarësisht vendbanimit apo kushteve ekonomike.

### Frekuentimi në arsimin fillor

| Gjinia | Numri i Nxënësve | Përqindja (%) |
|---|---|---|
| **Djem** | 2435 | 51.34 |
| **Vajza** | 2307 | 48.65 |
| **Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin fillor** | 4742 | |

Në arsimin fillor janë të regjistruar gjithsej 4742, nga të cilët 2435 janë djem dhe 2307 vajza. Sipas të dhënave të raportuara, 51.34% e tyre janë djem dhe 48.65% vajza. Kjo ndarje reflekton situatën e përfshirjes në këtë nivel arsimor, e cila ndryshon nga njësi në njësi, në varësi të kushteve lokale, demografisë, dhe mundësive të ofruara në komunitet. Të dhënat nënvizojnë rëndësinë e vazhdimit të përpjekjeve për të garantuar akses të barabartë dhe gjithëpërfshirës në arsimin fillor për të gjithë fëmijët, pavarësisht vendbanimit apo karakteristikave të tjera sociale. Sigurimi i kushteve të përshtatshme për ndjekjen e shkollës dhe mbështetja institucionale mbeten faktorë kyç për përmirësimin e mëtejshëm të përfshirjes.

### Frekuentimi arsimi 9-vjeçar

Në arsimin 9-vjeçar janë të regjistruar gjithsej 3828 nxënës, prej të cilëve 2006 janë djem dhe 1822 vajza. Sipas të dhënave, 52.40% e nxënësve janë djem dhe 47.60% janë vajza. Kjo shpërndarje pasqyron situatën aktuale të përfshirjes në këtë nivel arsimor, e cila ndryshon nga njësi në njësi dhe ndikohet nga faktorë të ndryshëm lokalë. Pavarësisht variacioneve, këto të dhëna nënvizojnë rëndësinë e monitorimit të rregullt të pjesëmarrjes së fëmijëve në arsim dhe nevojën për politika që mbështesin vazhdimësinë e shkollimit për të gjithë. Sigurimi i kushteve të favorshme për ndjekjen e arsimit 9-vjeçar është thelbësor për garantimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të barabartë për çdo fëmijë.

| Gjinia | Numri i Nxënësve | Përqindja (%) |
|---|---|---|
| **Djem** | 2006 | 47.60 |
| **Vajza** | 1822 | 52.40 |
| **Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin 9-vjeçar** | 3828 | |

### Frekuentimi arsimi i mesem

| Gjinia | Numri i Nxënësve | Përqindja (%) |
|---|---|---|
| **Djem** | 1999 | 52.03 |
| **Vajza** | 1843 | 47.97 |
| **Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin e mesëm** | 3842 | |

Sipas të dhënave të fundit nga INSTAT në arsimin e mesëm janë të regjistruar gjithsej 3842 nxënës, nga të cilët 1999 janë djem dhe 1843 vajza, përkatësisht 52.03% djem dhe 47.97% vajza. Ndarja gjinore në këtë nivel arsimor pasqyron situatën e raportuar për njësinë përkatëse, por këto përqindje mund të jenë të ndryshme në zona të tjera. Shpërndarja e pjesëmarrjes në arsimin e mesëm ndikohet nga faktorë të shumtë si zgjedhjet individuale, mundësitë për të ndjekur shkolla të përgjithshme apo profesionale, si dhe faktorë socialë, ekonomikë apo kulturorë. Kjo e bën të nevojshme që të mbështetet përfshirja e vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse në këtë nivel të rëndësishëm të arsimit.

## Analiza edhe shperndarja e stafit arsimor dhe atij mbështetës në territorin e bashkisë

**Stafi mbështetës për shërbimet në Shkolla**
Stafi ndihmës (roje, sanitare dhe punonjës të shërbimeve mbështetëse) për Shkollat përfshin gjithsej 57 roje, 124 sanitare dhe 19 punonjës të shërbimeve mbështetëse, staf i cili plotëson tërësisht nevojën e kërkuar për shërbimet mbëshetëse në shkolla.

**Stafi edukativ dhe mbështetës për shërbimet në Kopshte**
Bashkia Shkodër mbulon me paga një total prej 232 punonjësish në sektorin e arsimit nga të cilët 147 mbulojnë shërbimin në kopshte si më poshtë:

- 107 edukatore në arsimin parashkollor,
- 13 drejtues kopshti,
- 14 edukatore mbështetëse,
- 8 kuzhinere dhe 5 ndihmëse kuzhinere në kopshte.

Në kuadër të këtij programi, sigurohet furnizimi dhe mbështetja me ushqim për 7 kopshte, ku ofrohet drekë ditore për 1712 fëmijë. Kjo mbështetje ushqimore kontribuon në përmirësimin e kushteve të kujdesit dhe stimulon frekuentimin e vazhdueshëm të fëmijëve në institucionet parashkollore, veçanërisht në zonat me nevoja më të mëdha sociale dhe ekonomike.

## Shërbimi i arsimit sipas njësive administrative

**Njësia Administrative: Shkodër**

**Shkollat**

Bashkia Shkodër ka në kompetencën e saj administrimin dhe monitorimi e shkollave publike. Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu edhe në ato periferike apo rurale.

**Lista e shkollave të arsimit bazë përfshin:**

| Emri i shkolles | Emri i Qytetit/Fshatit | Qytet apo fshat | Lloji sipas ciklit | Specifikim |
|---|---|---|---|---|
| **"Ismail Qemali"** | Shkodër | Qytet | 9 - vjeçar | Klasike |
| **"Salo Halili"** | Shkodër | Qytet | 9 - vjeçar | Klasike |
| **"Azem Hajdari"** | Shkodër | Qytet | 9 - vjeçar | Klasike |
| **"Xheladin Fishta"** | Shkodër | Qytet | 9 - vjeçar | Klasike |
| **"Skenderbej"** | Shkodër | Qytet | 9 - vjeçar | Klasike |
| **"Dëshmorët e Prishtinës"** | Shkodër | Qytet | 9 - vjeçar | Klasike |
| **"Branko Kadia"** | Shkodër | Qytet | 9 - vjeçar | Klasike |
| **"Mati Logoreci"** | Shkodër | Qytet | 9 - vjeçar | Klasike |
| **"Ndoc Mazi"** | Shkodër | Qytet | 9 - vjeçar | Klasike |
| **"Martin Camaj"** | Shkodër | Qytet | 9 - vjeçar | Klasike |
| **"Pashko Vasa"** | Shkodër | Qytet | 9 - vjeçar | Klasike |
| **"Ali Laçej"** | Shkodër | Qytet | 9 - vjeçar | Klasike |
| **"Ndre Mjeda"** | Shkodër | Qytet | 9 - vjeçar | Klasike |
| **"Isuf Tabaku"** | Shkodër | Qytet | 9 - vjeçar | Klasike |
| **"Liria"** | Shkodër | Qytet | 9 - vjeçar | Klasike |
| **"Ruzhdi Daca"** | Shkodër | Qytet | 9 - vjeçar | Klasike |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **“Preke Jakova”** | Shkodër | Qytet | 9 – vjeçar bashkë me Shkollën e meme | Artistike |
| **“3 Dhjetori”** | Shkodër | Qytet | 9 - vjeçar | Speciale |
| **“Ernest Koliqi”** | Shkodër | Qytet | 9 - vjeçar | Klasike |
| **Zogaj** | Shkodër | Qytet | 9 - vjeçar | Klasike |
| **“Edith Durham”** | Shkodër | Qytet | 9 - vjeçar | Klasike |

**Lista e shkollave të arsimit të mesëm:**

| Shkolla | Emri i Qytetit/Fshatit | Lloji sipas programit | Specifikim i ne varesi te llojit | Me kohë te plote/ te pjesshme | E Bashkuar ose Jo |
|---|---|---|---|---|---|
| **“28 Nëntori”** | Shkodër | Gjimnaz | Klasike | Me kohë të plotë | E Veçantë |
| | Shkodër | Gjimnaz | Bilinguale | Me kohë të plotë | E Veçantë |
| **Jordan Misja** | Shkodër | Gjimnaz | Klasike | Me kohë të plotë | E Veçantë |
| **“Oso Kuka”** | Shkodër | Gjimnaz | Klasike | Me kohë të plotë | E Veçantë |
| | Shkodër | Gjimnaz | Bilinguale | Me kohë të plotë | E Veçantë |
| **“Kolë Idromeno”** | Shkodër | Gjimnaz | Klasike | Me kohë të plotë | E Veçantë |
| | Shkodër | Me kohe te shkurtuar | Natën | Me kohë të pjesshme | E Veçantë |
| **“Shejnaze Juka”** | Shkodër | Gjimnaze te orientuara | Gjuhe e Huaj | Me kohë të plotë | E Veçantë |
| **“Preke Jakova”** | Shkodër | Gjimnaze te orientuara | Artistike | Me kohë të plotë | E Bashkuar me 9VJ |

**Kopshtet**

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 21 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Anekset japin një lisim të e plotë të institucioneve të arsimit parashkollor publik në territorin e bashkisë Shkodër. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

**Lista e kopshteve përfshin:**

| Kopshti | Emri i Qytetit/Fshatit | Fshat/ Qytet | Me ushqim / Pa ushqim | Kapaciteti | Në ndërtesën e shkollës |
|---|---|---|---|---|---|
| **“1 Qershori”** | Shkodër | Qytet | Me Ushqim | 30 | Po |
| **“Ngjyrat”** | Shkodër | Qytet | Me Ushqim | 120 | Jo |
| **“Ajasëm”** | Shkodër | Qytet | Pa Ushqim | 20 | Po |
| **“Ali Laçej”** | Shkodër | Qytet | Pa Ushqim | 50 | Po |
| **“Azem Hajdari”** | Shkodër | Qytet | Pa Ushqim | 50 | Po |
| **“Bep Tusha”** | Shkodër | Qytet | Me Ushqim | 115 | Jo |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **"Dëshmorët e Prishtinës** | Shkodër | Qytet | Pa Ushqim | 20 | Po |
| **"Fetah Barbullushi** | Shkodër | Qytet | Pa Ushqim | 80 | Jo |
| **"Gjuhët e Huaja"** | Shkodër | Qytet | Pa Ushqim | 30 | Po |
| **"Ismail Qemali"** | Shkodër | Qytet | Pa Ushqim | 25 | Po |
| **"Ismet Sali Bruçaj"** | Shkodër | Qytet | Me Ushqim | 120 | Jo |
| **"Liria"** | Shkodër | Qytet | Pa Ushqim | 30 | Po |
| **"Njomëzat"** | Shkodër | Qytet | Me Ushqim | 100 | Jo |
| **"Ndoc Mazi"** | Shkodër | Qytet | Pa Ushqim | 50 | Po |
| **"Pashko Vasa"** | Shkodër | Qytet | Pa Ushqim | 50 | Po |
| **"Edith Durham"** | Shkodër | Qytet | Me ushqim | 80 | Po |
| **"Ruzhdi Daca"** | Shkodër | Qytet | Pa Ushqim | 25 | Jo |
| **"Shirokë"** | Shkodër | Qytet | Pa Ushqim | 25 | Po |
| **"Ton Alimhilli"** | Shkodër | Qytet | Me Ushqim | 120 | Jo |
| **"Xixëllonjat"** | Shkodër | Qytet | Pa ushqim | 120 | Jo |
| **"Zogaj"** | Shkodër | Qytet | Pa Ushqim | 20 | Po |

**Njësia Administrative: Ana e Malit**

**Shkollat**

Në këtë njësi funksionojnë 5 shkolla,
Njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimimit dhe mirëqenies sociale.

**Lista e shkollave përfshin:**

| Emri i Shkollës |
|---|
| "Hasan Dardhanjori" |
| "Qazim Mehja" |
| "Elbacë" |
| "Veli Tela" |
| Oblikë "Idriz Hoxha" |

**Kopshtet**

Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 4 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

**Lista e kopshteve përfshin:**

| Emri i kopshtit |
|---|
| "Qazim Mehja" |
| "Hasan Dardhanjori" |
| "Veli Tela" |
| "Elbacë" |

**Njësia Administrative: Bërdicë**

**Shkollat**

Në total, funksionojnë 4 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. 3 prej tyre janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, dhe 1 është shkollë e mesme e bashkuar.

**Lista e shkollave përfshin:**

| Emri i Shkollës |
|---|
| "Frederik Gjon Gjoni" (SHMB) |
| "Agim Tafili" |
| "Dom Mikel Gjergji" |
| "Seit Can Tagani" |

**Kopshtet**

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative janë të hapura gjithsej 3 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

**Lista e kopshteve përfshin:**

| Emri i kopshtit |
|---|
| "Frederik Gjon Gjoni" |
| "Agim Tafili" |
| "Seit Can Tagani" |

**Njësia Administrative: Dajç**

**Shkollat**

Në total, funksionojnë 2 shkolla, 1 prej tyre është shkollë 9-vjeçare dhe 1 shkollë të mesme e bashkuar.

**Lista e shkollave përfshin:**

| Emri i Shkollës |
|---|
| "Pjetër Gaci" |
| "Lucë Agraja" (SHMB) |

**Kopshtet**

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon 1 kopsht.

**Lista e kopshteve përfshin:**

| Emri i kopshtit |
|---|
| Shirq - "Pjetër Gaci" |

**Njësia Administrative: Guri i Zi**

**Shkollat**

Në total, funksionojnë 7 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, 6 shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, dhe 1 shkollë e mesme e bashkuar.

Përmes këtij sistemi, njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimimit dhe mirëqenies sociale.

**Lista e shkollave përfshin:**

| Emri i Shkolles |
|---|
| "Arif Selimi" |
| "Zef Jubani" |
| "Dëshmorët e Rrencit" |
| "At Gjon Karma" (SHMB) |
| "Tonc Gjon Toma" |
| "Sheldi" |
| "Kuç" |

**Kopshtet**

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative aktualisht, janë të hapura gjithsej 5 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit

**Lista e kopshteve përfshin:**

| Emri i kopshtit |
|---|
| Guri i Zi - "At Gjon Karma" |
| "Kuç" |
| Rrenc- Dëshmorët e Rrencit |
| Vukatanë "Arif Selimi" |
| Juban - "Zef Jubani" |

**Njësia Administrative: Postribë**

**Shkollat**

Në këtë njësi administrative funksionojnë 8 shkolla, 7 prej tyre janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, dhe 1 është shkollë e mesme e bashkuar.

**Lista e shkollave përfshin:**

| Emri i Shkolles |
|---|
| "Adem Haxhija" (SHMB) |
| Drisht |
| "Ismet Çelaj", Dragoç |
| Domen |
| Ura E Shtrenjte |
| Prekal |
| Vilez |
| Mes-Myselim |

**Kopshtet**

Në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 5 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

**Lista e kopshteve përfshin:**

| Emri i kopshtit |
|---|
| Dragoç |
| Postribë- "Adem Haxhija" |
| Kullaj |
| Drisht |
| Mes Myselim |

**Njësia Administrative: Pult**

**Shkollat**

Në total në këtë njësi janë 6 institucione arsimore. Nga këto, 3 shkolla janë godina për ciklin fillor, ndërsa 3 prej tyre është shkollë 9-vjeçare.

**Lista e shkollave përfshin:**

| Emri i Shkolles |
|---|
| Kir |
| Xhan |
| Kasnec |
| Pog |
| Plan |
| Brucaj |

**Njësia Administrative: Rrethinat**

**Shkollat**

Në këtë njësi funksionojnë 9 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, 1 shkollë është në ciklin fillor, ndërsa 8 prej tyre janë shkolla 9-vjeçare.

**Lista e shkollave përfshin:**

| Emri i Shkolles |
|---|
| "Isa Jakupi" |
| "Tringë Smajli" |
| Hot i Ri |
| Shtoj i Ri |
| Shtoj i Vjetër |
| "Ismet Sali Brucaj" |
| Bardhaj |
| Zues |
| "Haxhi Hajdari" |

**Kopshtet**

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 9 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

**Lista e kopshteve përfshin:**

| Emri i kopshtit |
|---|
| Dobraç- "Isa Jakupi" |
| Golem- "Haxhi Hajdari" |
| Guci e Re |
| Shtoj i Ri |
| Shtoj i vjetër |
| Hot i Ri |
| Grudë e Re- "Tringë Smajli" |
| Zues |
| Bardhaj |

**Njësia Administrative: Shalë**

**Shkollat**

Në total, funksionojnë 2 shkolla të arsimit bazë dhe 1 e mesme e bashkuar.

**Lista e shkollave përfshin:**

| Emri i Shkolles |
|---|
| "Mehmet Shpendi" (SHMB) |
| Theth |
| Gimaj |

**Njësia Administrative: Shosh**

**Shkollat**

**Në total, funksionojnë 3 shkolla. Nga këto, 2 shkolla janë në ciklin fillor, ndërsa 1 prej tyre është shkollë 9-vjeçare.**

**Lista e shkollave përfshin:**

| Emri i Shkolles |
|---|
| Nicaj-Shosh |
| Palaj-Shosh |
| "Dom Prek Ndrevashaj" |

**Njësia Administrative: Velipojë**

**Shkollat**

Në total, funksionojnë 2 shkolla, njëra 1 prej tyre është shkollë 9-vjeçare dhe tjetra është shkollë e mesme e bashkuar.

**Lista e shkollave përfshin:**

| Emri i Shkolles |
|---|
| "Gjergj Vatë Martini" |
| "Nikolle Zogorjani" (SHMB) |

**Kopshtet**

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 3 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

**Lista e kopshteve përfshin:**

| Emri i kopshtit |
|---|
| Velipojë – Njësia Administrative |
| "Gjergj Vatë Martini" |
| "Nikoll Zagorjani" |

## Vizioni, Qëllimet Strategjike, Objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar



**Vizioni**

***"Bashkia Shkodër synon të zhvillojë një sistem arsimor parauniversitar gjithëpërfshirës, të barabartë dhe të qëndrueshëm, i cili garanton akses për çdo fëmijë dhe të ri në territor, siguron mjedise të sigurta dhe cilësore të të nxënit, në përputhje me nevojat e komuniteteve urbane dhe rurale."***

**Vizioni i Bashkisë Shkodër për arsimin parauniversitar** përfaqëson një angazhim afatgjatë, kolektiv dhe transformues për ndërtimin e një sistemi edukimi që është jo vetëm i drejtë dhe i hapur, por edhe i qëndrueshëm, cilësor dhe në shërbim të çdo fëmije dhe të ri, pavarësisht vendbanimit, gjinisë, origjinës etnike apo statusit social-ekonomik. Ky vizion nuk kufizohet në ofrimin formal të arsimit, por synon të krijojë mjedise të sigurta, stimuluese dhe gjithëpërfshirëse ku çdo fëmijë mund të zhvillojë potencialin e tij të plotë intelektual, emocional, social dhe fizik.

Në qendër të këtij vizioni qëndron parimi themelor i **aksesit të barabartë**: çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Shkodër, qoftë ai që jeton në qendrën urbane me dendësi të lartë popullore apo ai që rritet në një fshat malor të izoluar ka të drejtën për një arsim cilësor, të përshtatur nevojave të tij dhe në harmoni me realitetin e komunitetit ku banojnë. Vizioni njeh sfidat komplekse që rrjedhin nga tkurrja demografike në zonat rurale, migrimi brendshëm dhe jashtë vendit, si dhe nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të infrastrukturës, stafit arsimor dhe shërbimeve mbështetëse. Prandaj, ai synon të tejkalojë këto pengesa jo vetëm përmes investimeve materiale, por edhe përmes politikave aktive përfshirëse, bashkëpunimit me familjet dhe komunitetet lokale, dhe forcimit të kapaciteteve institucionale në nivel vendor.

Në përputhje me këtë qasje, sistemi arsimor parauniversitar në Shkodër do të ndërtohet mbi katër shtylla strategjike:

1. **Përfshirja aktive**, duke vepruar kundër çdo forme përjashtimi social, ekonomik, gjuhësor apo lidhur me aftësitë;

2. **Barazia në mundësi**, duke garantuar që çdo nxënës, pavarësisht nga sfondi i tij, të ketë akses në infrastrukturë të përshtatshme, staf të kualifikuar, mjete didaktike moderne dhe ushqim të balancuar;
3. **Kohezioni social**, duke e kthyer shkollën dhe kopshtin në qendra dinamike të jetës komunitare, ku arti, sporti, kultura dhe vlerat civike kultivohen si pjesë e procesit edukativ;
4. **Efikasiteti institucional**, duke përdorur menaxhimin bazuar në të dhëna, dixhitalizimin e shërbimeve arsimore dhe transparencën e vendimmarrjes për të përmirësuar vazhdimisht cilësinë e arsimit.

**Përmbledhje e qëllimeve, objektivave dhe aktiviteteve**

☑ **Qëllimi 1: Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar;**

Bashkia Shkodër synon të garantojë funksionimin efikas të institucioneve arsimore dhe parashkollore, përmes investimeve në infrastrukturë dhe përmbushjes së kushteve themelore për një mjedis të sigurt dhe të përshtatshëm për fëmijët.

**Objektivat specifikë:**

- O1. Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilesore per zhvillimin e procesit mesimor ne sistemin parauniversitar dhe parashkollor. Treguesi ( Numri i fëmijëve në nevojë dhe me aftësi të kufizuar të mbështetur nga Bashkia).
- O2. Organizimin e aktiviteteve dhe promovimin e identitetit kombetare e lokal,si dhe administrimin e objekteve qe lidhen me ushtrimin e ketyre aktiviteteve.
- O3. Krijimi i ambjenteve dhe mjediseve te sistemit arsimor baze dhe parashkollor., te sigurte konform standarteve ligjore.

☑ **Qëllimi 2:Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar ne arsimin e mesem te pergjithshem dhe profesional;**

Bashkia Shkodër synon të rrisë aksesin dhe cilësinë e edukimit parashkollor, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve në situata të cenueshme dhe duke garantuar përfshirje të barabartë për të gjithë.

**Objektivat specifikë:**

- O1 Ofrimi i shërbimeve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor edukativ në kushte të përshtatshme në gjithë territorin administrativ të Bashkisë së Shkodrës në arsimin e mesëm të përgjithshëm.
- O2 Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor në arsimin e mesëm të përgjithshëm.

## Përmbledhje e investimeve (2025–2028)

Më poshtë tabela përmbledhëse e projekteve të investimeve:

| KODI | EMËRTIMI I PROJEKTIT/PRODUKTIT | KOSTO TOTALE | 2025 BUXHETI | 2026 PLANI | 2027 PLANI | 2028 PLANI |
|---|---|---|---|---|---|---|
| P912ABN | Shkolla e hapur Ndre Mjeda (1410965) | 62,268 | 62,268 | 0 | 0 | 0 |
| P923AAM | Shkolla e hapur "Kolë Idromeno" (1410966) | 26,968 | 26,968 | 0 | 0 | 0 |
| P923AAO | Rikonstruksion shkolla te mesme te pergjithshme (P923AAO) | 20,991 | 0 | 0 | 5,000 | 15,991 |
| P912ABO | Projekte Rikonstruksion i shkollave dhe fusha sporti (1410948) | 16,487 | 4,687 | 11,800 | 0 | 0 |
| P912ABP | Rikonstruksion I kopshtit Bep Tusha | 1,571 | 1,571 | 0 | 0 | 0 |
| P923AAN | Projektim Rikonstruksion shkolla te mesme te pergjithshme (1410961) | 3,316 | 3,316 | 0 | 0 | 0 |
| P912ADQ | Rikonstruksion I godinave shkollore | 10,000 | 0 | 0 | 0 | 10,000 |
| P912ABU | Instalimi i sistemit të ngrohjes shkolla "Branko Kadia",shkolla "Azem Hajdari",shkolla " Mati Logoreci" (P912ABU) | 25,328 | 25,328 | 0 | 0 | 0 |
| P912ABV | Ndertimi i tualeteve te reja shkolla "Skenderbej" (P912ABV) | 5874 | 5,874 | 0 | 0 | 0 |
| P912ABX | Rikonstruksion I pjesshëm i kopshtit Ton Alimhilli (P912ABX) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| P912ABT | Instalimi I ngrohjes qendrore ne shkolla 9-vjecare (P912ABT) | 20.418 | 20,418 | 0 | 0 | 0 |
| P923AAP | Rikonstruksion shkolla Mehmet Shpendi Nj Ad Shale (P923AAP) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| P912ACD | Rikonstruksion Kopshti Ton Alimhilli (P912ACD) | 5,567 | 967 | 4,600 | 0 | 0 |
| P912ACE | Rikonstruksion dhe ndërtim palestre Shkolla e hapur Ismail Qemali (P912ACE ) | 29,981 | 0 | 29,981 | 0 | 0 |
| P912ACF | Rikonstruksion Shkolla Salo Halili (P912ACF) | 5,279 | 5,279 | 0 | 0 | 0 |
| P912ACG | Rikonstruksion Shkolla Ndoc Mazi (P912ACG) | 5,297 | 5,279 | 0 | 0 | 0 |
| P912ADO | Shtese dhe sistem kapote Shkolla Shtoj i Ri | 1,103 | 0 | 1,103 | 0 | 0 |
| P912ADP | Shtese dhe sistem kapote Shkolla Xheladin Fishta | 1,976 | 0 | 1,976 | 0 | 0 |
| P043-SH-004 | Rikonstruksion Çerdhe Perash | 1,640 | 0 | 1,640 | | |
| | **Totali i Shpenzimeve Kapitale sipas Projekteve** | | 161,955 | 51,099 | 5,000 | 25,991 |
| V912AAB | Objekte të Arsimit Baze dhe Parashkollor të Mirëmbajtura dhe Funksionale | 34,021 | 3,421 | 19,200 | 5,700 | 5,700 |
| V912AAD | Fëmijë që Ndjekin Kopështin | 12,286 | 286 | 4,000 | 4,000 | 4,000 |
| V912AAK | Objekte të Arsimit Bazë dhe Parashkollor të Rikonstruktuara | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| V923AAB | Objekte te Arsimit të Mesëm të Mirëmbajtura dhe Funksionale | 10,172 | 357 | 6,605 | 1,605 | 1,605 |
| V923AAF | Nxënës të Akomoduar në Konvikt | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| V043AAC | Fëmijë që Frekuentojnë Çerdhet | 4,128 | 2,928 | 400 | 400 | 400 |
| | **Totali i Shpenzimeve Kapitale sipas Produkteve** | 60,607 | 6,992 | 30,205 | 11,705 | 11,705 |
| **Totali i Përgjithshëm** | | | 168,965 | 81,304 | 16,705 | 37,696 |

**Investimet kapitale në arsimin bazë dhe të mesëm (2026–2028)**

Për arsimin bazë dhe të mesëm, Bashkia Shkodër ka parashikuar një sërë investimesh strategjike që synojnë përmirësimin e infrastrukturës shkollore, rritjen e sigurisë, funksionalitetit dhe cilësisë së mjedisit të të nxënit.

Së pari, për shkollat e mesme të përgjithshme është planifikuar një program rikonstruksioni me një fond total prej **20,9 milionë lekësh**, i shpërndarë progresivisht gjatë dy viteve (2027–2028), me rritje të ndjeshme në vitin e dytë për të mbuluar nevojat më të mëdha strukturore.

Ndërkohë, është parashikuar një program i posaçëm për **mirëmbajtjen dhe funksionalitetin e objekteve të arsimit bazë dhe parashkollor**, me një investim të ndarë për vitin 2026, 19.2 milionë lekësh, për vitin 2027 dhe 2028 janë përkatësisht nga 5,7 milionë lekësh secili . Ky program do të sigurojë vazhdimësinë e kushteve bazë në institucionet ekzistuese, duke garantuar mjedise të sigurta dhe të përshtatshme për çdo nxënës.

Po ashtu, për vitin 2026 është parashikuar një projekt për **rikonstruksionin e objekteve arsimore dhe fushave sportive** me një vlerë prej **11,8 milionë lekësh**, duke pasqyruar angazhimin e bashkisë për të integruar dimensionin fizik dhe sportiv si pjesë thelbësore e zhvillimit të plotë të nxënësve.

Në fushën e edukimit të hershëm, është parashikuar **blerja e orendive dhe pajisjeve për çerdhet**, me një buxhet vjetor prej **400 mijë lekësh** për secilin vit, duke arritur në një shumë totale prej **1,2 milionë lekësh**. Kjo mbështetje synon të përmirësojë cilësinë e mjediseve të kujdesit për fëmijët më të vegjël, duke u dhënë atyre një fillim të fortë në rrugën e të mësuarit.

Së fundmi, një nga investimet më të rëndësishme është ai për **rikonstruksionin dhe ndërtimin e palestrës në shkollën e hapur "Ismail Qemali"**, me një vlerë prej **29,981 milionë lekësh në vitin 2026**. Ky projekt reflekton përkushtimin e qëndrueshëm të Bashkisë Shkodër ndaj zhvillimit fizik, shëndetit dhe mirëqenies së nxënësve, si dhe përmirësimit të kushteve për arsim cilësor në nivel të mesëm.

Ky angazhim vjen në vazhdim të suksesit të rikonstruksionit të plotë të shkollës **"Ndre Mjeda"**, një model referimi që ka dhënë mundësi qindra fëmijëve të mësojnë sot në mjedise moderne, të sigurta dhe të stimuluese. Me këto investime, Bashkia Shkodër nuk po ndërton vetëm godina—po ndërton besimin, të ardhmen dhe mundësitë reale për çdo fëmijë, në çdo lagje dhe fshat të territorit të saj.

Dy projektet e para ajo e shkollës **"Ndre Mjeda"** dhe **"Kolë Idromeno"** janë projektë të bashkëfinancuara me Ministrinë e Arsimit ku vlera e plotë ishtë 133,131,532 (K.Idromeno) dhe 238,760,368 (Ndre Mjeda). Për shkollën **"Ndre Mjeda"** nga MAS vlera financimit (60,000,000 për 2024 dhe 119,070,276 për 2025, 2026) ndërsa për shkollën **"Kolë Idromeno"** (35,000,000 për 2024 dhe 64,848,649 për 2025).

Për shkollat Shtoj i Ri dhe Xheladin Fishta janë parashikuar "Shtesë dhe sistem kapote" përmes kësaj ndërhyrje do të sigurohet termoizolimi i godinave ekzistuese dhe i shtesës së re synon të sigurojë një mjedis termik të qëndrueshëm gjatë gjithë vitit. Projekti parashikon izolimin e mureve të jashtme, çatisë dhe ndërrimin e dritareve me sisteme efikase energjetike. Ky investim do të ulë ndjeshëm humbjet e energjisë, do të krijojë kushte optimale të të nxënit dhe do të reduktojë shpenzimet e shkollës për ngrohje dhe ftohje. Vlera është prej **1.1 milion për shkollën Shtoj e Ri dhe 1.9 për shkollën Xheladin Fishta.**

Projekti tjetër i nevojshëm për Çerdhen Perash synon rikonstruksionin dhe modernizimin e çerdhes, përmirësimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme, rritjen e performancës energjetike dhe të sigurisë, si dhe krijimin e një mjedisi funksional, të aksesueshëm dhe rekreativ për fëmijët. Ky investim prej 1.6 milion lekësh do të garantojë kushte të përshtatshme, të sigurta dhe bashkëkohore për zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve.

Investimet e listuara në tabelën e mësipërme, janë prova e qartë se arsimi nuk është thjesht një shërbim publik, por një prioritet moral, një akt dashurie për brezat e ardhshëm dhe një themel i pandashëm për një shoqëri më të drejtë, më të përfshirëse dhe më të qëndrueshme.

**Investimet kapitale në arsimin parashkollor (2026–2028)**

Për arsimin parashkollor, plani i investimeve kapitale për periudhën 2026–2028 fokusohet në rikonstruksionin e institucioneve kyçe që shërbejnë zonat me dendësi më të lartë popullimore në qytetin e Shkodrës.

Në këtë kuadër, veçohen dy projekte strategjike:

1. **Rikonstruksioni i kopshtit "Ton Alimhilli"** është planifikuar të realizohet në tërësi gjatë vitit 2026. Ky projekt përfshin përmirësime të plota infrastrukturore, me qëllim garantimin e **sigurisë fizike, funksionalitetit operativ** dhe **përputhjes me standardet bashkëkohore** për mjediset e edukimit të hershëm. Ai synon të përmirësojë drejtpërdrejt cilësinë e shërbimit, kapacitetin pritës dhe përvojën zhvillimore të fëmijëve të moshës 3–6 vjeç.
2. **Rikonstruksioni i kopshtit "Bep Tusha"**, një tjetër ndërhyrje e rëndësishme që do të kontribuojë në forcimin e rrjetit parashkollor urban. Edhe ky projekt do të realizojë përmirësime integrale infrastrukturore, duke u fokusuar në kushte të sigurta, hapësira të stimuluese për lojë dhe mësim, si dhe aksesueshmëri për të gjithë fëmijët, përfshirë ata me nevoja të veçanta.

Së bashku, këto dy investime përfaqësojnë përkushtimin e Bashkisë Shkodër për transformimin e mjediseve parashkollore në hapësira moderne, të përfshira dhe të orientuara drejt zhvillimit të plotë të fëmijës. Ato janë në pajtim me vizionin afatgjatë për një sistem arsimor parauniversitar **gjithëpërfshirës, të barabartë dhe të qëndrueshëm**, dhe reflektojnë prioritetin për ta bërë edukimin e hershëm jo vetëm më të aksesueshëm, por edhe më cilësor në zonat me presion demografik më të lartë.

## Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar

**Të ardhurat vendore dhe transferimet nga qeveria qendrore për shërbimin e arsimit parauniversitar**

**Të dhënat financiare për shërbimin e arsimit parauniversitar**
Ky seksion përmbledh informacionin financiar që lidhet me funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të arsimit parauniversitar në nivel bashkie.
Bashkia siguron financim për arsimin bazuar në të ardhurat përmes transfertave specifike dhe të përgjithshme të siguruara nga qeveria qendrore si dhe nga taksat dhe tarifat vendore. Transferimet specifike mbulojnë zërat e mëposhtëm:

- Arsimi parashkollor: përfshirë pagat e stafit arsimor dhe ndihmës, kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimin e infrastrukturës së kopshteve, si dhe mbështetjen për përfshirje të fëmijëve nga grupe vulnerabël.

- Arsimi 9-vjeçar Arsimi i mesëm: përfshirë pagat për punonjësit ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së shkollave;
- Arsimi profesional përfshin ofrimin e shërbimet për nxënësit e arsimit professional që frekuentojnë dhe konviktet;

Të dhënat financiare janë të raportuara në mijë lekë dhe pasqyrojnë kontributin për secilën kategori për vitin aktual, si dhe për vitet e mëparshme për të mundësuar analizë krahasimore.
Ky informacion është i domosdoshëm për të kuptuar financimin buxhetor të shërbimit të arsimit parauniversitar, mënyrën e plaifikuar të përdorimit të fondeve publike për arsimin parauniversitar, si dhe për të identifikuar boshllëqet ose mundësitë për investime të reja në funksion të përmirësimit të cilësisë së edukimit.

**Arsimi bazë (përfshirë arsimin parashkollor) dhe Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm**

Buxheti që mbështet planin për zhvillimin dhe mbështetjen e arsimit për periudhën 2026–2028 janë të shpërndara si më poshtë:

| KODI | EMËRTIMI I LLOGARISË | PLANI 2026 | PLANI 2027 | PLANI 2028 |
|---|---|---|---|---|
| | **Shpenzime Personeli (600-601)** | **510,194** | **510,195** | **510,195** |
| 600 | Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli | 440,182 | 440,183 | 440,183 |
| 601 | Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore | 70,012 | 70,012 | 70,012 |
| | **Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)** | **206,445** | **208,422** | **208,422** |
| 602 | Mallra dhe sherbime te tjera | 190,445 | 192,422 | 192,422 |
| 603 | Subvencionet | 0 | 0 | 0 |
| 604 | Transferime korrente te brendeshme | 16,000 | 16,000 | 16,000 |
| 605 | Transferimet korrente jashte | 0 | 0 | 0 |
| 606 | Transferta per buxhetet familiare dhe individet | 0 | 0 | 0 |
| 609 | Rezervat | 0 | 0 | 0 |
| 651 | Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme | 0 | 0 | 0 |
| 1661 | Te dala, huamarrje te tjera afatgjate | 0 | 0 | 0 |
| | **Shpenzime Kapitale (230-232, 255)** | **81,304** | **16,705** | **37,696** |
| 230 | Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara | 16,519 | 0 | 0 |
| 231 | Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara | 64,785 | 16,705 | 37,696 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 232 | Shpenzime transferimet kapitale | 0 | 0 | 0 |
| 255 | Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme | 0 | 0 | 0 |
| **TOTALI** | | **797,943** | **735,322** | **756,313** |

Në programin Arsimi Bazë dhe Parashkollor janë planifikuar të mbështeten dhe rikontruksione të strukturave shkollore dhe parashkollore.

Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit tonë. Shkolla duhet t'i mundësojë të gjithë fëmijëve që të kenë rezultate në mësime, të jenë të sigurtë, të shëndetshëm dhe aktivë në jetën komunitare.

Për administrimin e funksionimin e shkollave të arsimit bazë dhe të mesëm të përgjithshëm kërkohet mbështetja dhe financimi për shërbimet dhe mirëmbajtjen e zakonshme të objekteve arsimore për arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe profesional.

Bashkia Shkodër, çdo vit bën ndërhyrje dhe mirëmbajtje në shkolla, çerdhe dhe kopshte. Rregullimi dhe riparimi i këtyre ambienteve, për të krijuar kushte normale në institucionet arsimore, realizohet duke vlerësuar kërkesat e paraqitura nga shkollat, çerdhet dhe kopshtet të njësive administrative dhe atyre në qytet të paraqitura nga dëgjesat publike.

Një drejtim i rëndësishëm i mbështetjes nga ana e Bashkisë Shkodër për këto ambiente është dhe sigurimi i objekteve për raste të ngjarjeve të jashtëzakonshme si zjarr dhe tërmete për arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe arsimin parashkollor. Çdo vit është planifikuar për të bërë sigurimin e objekteve, kryesisht për çerdhet, kopshtet, shkollat që janë me numër më të madh nxënësish.

Këto aktivitete janë të orientuara drejt ndërtimit të një mjedisi mësimor gjithëpërfshirës dhe efektiv, duke kontribuar njëkohësisht në reduktimin e braktisjes shkollore dhe forcimin e lidhjes midis arsimit dhe zhvillimit lokal.

## Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)

**Qëllimi 1 (Q1) Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar.**

| **Objektivi specifik O1.1 Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor në sistemin parauniversitar dhe parashkollor. (Sipas treguesit)** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitete** | **Periudha e zbatimit** | **Përgjegjës** | **Partnerë** | **Burimet financiare** | **Të dhëna dhe/ose Tregues** |
| **Angazhimi i mësuesve ndihmës në kopshte dhe stafit mbështës për rritjen e efikasitetit edukativ.** | 2026–2028 | Drejtoria Arsimit, Burimet Njerëzore, | OJQ Sociale, MAS | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike përfshirë në zërin "*Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli*" dhe "*Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore*" | —Numri i kopshteve.<br>—Numri i fëmijëve që frekuentojnë kopshtet me drekë.<br>—Nr. i fëmijëve në nevojë dhe me aftësi të kufizuar të mbështetur nga bashkia në kopshte.<br>—Raporti i numrit të nxënësve kundrejt nr. total të mësuesve në arsimin bazë.<br>—Numri mesatar i nxënësve në një klasë, arsimi bazë.<br>—Numri i shkollave që i shërbejnë fëmijëve me aftësi të veçanta.<br>—Numri i shkollave me shërbim sigurie, arsimi bazë.<br>—Numri mesatar i fëmijëve për kopësht. |
| **Institucionalizimi dhe funksionalizimi i strukturave menaxhuese pjesëmarrëse dhe këshilluese në institucionet arsimore, përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e** | 2026–2028 | Drejtoria Arsimit, | Administratorët e Njësive Administrative; Këshilli bashkiak; | Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor) | —Struktura menaxhuese në kopshte dhe shkolla aktive. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit në kopshtet dhe shkollat.** | | | Kopshtet; Prindërit | | |
| **Ofrimi i shërbimit psiko-social në kopshte shtimi në staf i psikologëve** | 2026–2028 | Drejtoria Arsimit,Burimet Njerëzore, | Kopshtet; OSHC | Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor) | —Nr. i fëmijëve (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) të mbështetur me shërbim psiko social. |
| **Mbështetja e nxënësve nga familjet në nevojë** | 2026–2028 | Drejtoria Arsimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale | Shkollat, Njësitë Administrative, OJQ | Buxhet vendor + donacione + projekte sociale | —Nr. i fëmijëve në nevojë dhe me aftësi të kufizuar nga bashkia në kopshte. |
| **Ofrimi i shërbimit të ushqimit për fëmijët në institucionet parashkollore**<br>- Sigurimi i vakteve ditore të shëndetshme dhe të balancuara për fëmijët që ndjekin kopshtet publike dhe shërbimi ushqimor në institucionet e arsimit parashkollor<br>**-Sigurimi i objekteve të arsimit parashkollor, dezifektimi, furnizimi me Ë dhe ujë,materiale pastrimi etj.** | 2026–2028 | Drejtoria Arsimit | Operatorët e licencuar, Ministria e Arsimit, Sportit (MAS) | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin "*Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime*" | —Numri i kopshteve<br>—Numri i kopshteve me dreke |
| **Mirëmbajtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës arsimore**<br>- Zbatimi i ndërhyrjeve mirëmbajtjes të planifikuara dhe emergjente për ruajtjen e funksionalitetit dhe sigurisë së | 2026–2028 | Drejtoria Arsimit DPMOP; | Shkollat, kopshtet | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike perfshire ne zerin "Shpenzime | —Sipërfaqe në $m^2$ në shërbim që mirëmbahet. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| ambienteve shkollore dhe parashkollore.<br>-Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve teknike | | | | Korrente, Mallra dhe sherbime" | |
| **Sigurimi i sistemeve funksionale të ngrohjes në institucionet arsimore parauniversitare**<br>- Instalimi, monitorimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të ngrohjes për të garantuar kushte komode në periudha të ftohta. | 2026–2028 | Drejtoria Arsimit, DPMOP | Operatorë të energjisë, | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin "*Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime*" | —Numri i shkollave që ngrohen me dru zjarri, arsimi bazë,<br>—Numri i shkollave që ngrohen me kaldaja dhe naftë, arsimi bazë. |
| **Sigurimi i objekteve per raste te ngjarjeve te jashtezakonshme si zjarr dhe termete arsimi baze dhe të mesëm (siguracioni i ndërtesës )** | 2026–2028 | Drejtoria Arsimit | | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin "*Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime"1* | —Nr. i objekteve arsimore të siguruara |
| **Furnizimi me dokumentacion administrativ për nevojat institucionale për institucionet e arsimit parauniversitar**<br>Prokurimi i regjistrave, formularëve dhe dokumenteve të tjera që mbështesin funksionimin administrativ të shkollave dhe kopshteve. | 2026–2028 | Drejtoria Arsimit | Shkollat | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin "*Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbim*" | —Nr. i shkollave/kopshteve të pajisura me dokumentacion |
| **Mbështetje për infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse (kancelari)**<br>- Mbështetja e procesit mësimor | 2026–2028 | Drejtoria Arsimit | Kopshtet MAS | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin | —Nr. i institucioneve të arsimit të pajisura me mjete didaktike |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
